

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ELIO CONSTRUCTION SHPK

Neni 1

Në zbatim të ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtarët dhe shoqërite tregtare" dhe ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë, themeluesit:

• **Arjeta Ndoci** shtetase Shqiptare lindur më 14/12/1987 në Kruje, identifikuar me kartë ID nr 037527774, e vlefshme deri me 03/08/2031, madhor e me zotesi të plotë ligjore për të vepruar.

vendosi sot për themelimin e kompanisë "Elio Construction" shpk.

Neni 2

Shoqeria do të mbajë emrin "Elio Construction" shpk dhe emer tregëtar "Elio Construction"

Neni 3

Forma ligjore

Kompania është një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar në bazë të ligjit n. 9901 datë 14.14.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" shoqeria mund të konvertohet në një formë tjetër me vendim të themeluesve të saj.

Neni 4

Baza ligjore

Shoqeria do të vazhdojë veprimtarinë e saj në përputhje me kete statut dhe të ligjit n.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" si dhe dispozitave të tjera të legjislacionit shqiptar.

Neni 5

Kohëzgjatja

Aktiviteti i Shoqerise do të fillojë në datën e regjistrimit të tij në QKB. Kohëzgjatja e aktivitetit te kesaj shoqerie do te jete me afat te papercaktuar.

Neni 6

Selia

Shoqeria do të ketë seline e saj të regjistruar në: Tirane, Dajt Shishtufine, Njesia administrative Dajt, Rruga "Shefik Qefalia", Nr.15, Tufine.

Selia e shoqerise mund të ndryshohet me vendim te administratorit te shoqërisë, por vetëm brenda rajonit.

Shoqeria ka të drejtë të themelojë degët, filiale dhe zyrat e përfaqësimit ne gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqeria mund të marre pjesë në shoqeri të tjera që do të krijojnë aktivitetet ekzistuese ose të ardhshme në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj me vendimin e ortakeve themelues.

Neni 7

Vula

Shoqeria do të ketë vulën e saj me te drejte perdorimi nga administratori i saj. Forma e vulës dhe madhësia e saj do të përcaktohet nga ortaku themelues në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

Neni 8

Objekti

Prodhim, tregetim, import, eksport, distribucion, ekskluzivitet, shitje me shumice dhe pakice te mobilieve si dhe lendeve te para per prodhimin e mobiljeve duke perfshire por pa kufizuar ne materialet dhe outputet e lendeve drusore dhe metalike. Prodhim dhe konstruksion i strukturave te ndryshme te drurit, metalit dhe plastikes; Hapja e fabrikave dhe punishteve per prodhimin e mobiljeve; Kerkim, konsulence, projektim, zbatim, zhvillim, dhe instalim i strukturave dhe profileve te ndryshme te drurit, xhamit, plastikes, metaleve etj. Qarkullimi i mallrave dhe sherbimeve ne tregun e jashtem dhe te brendeshem; Hapja e zyrave per disenjim, projektim, konsulence teknike dhe arredime te ambjenteve te ndryshme;

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj dhe ne kryerjen e veprimeve qe kane lidhje me pasuri te paluajtshme si blerjen, shitjen, ndertimin, rikonstruksionin, restaurimin e ndertesave, administrimin e banesave sociale, aktivitetin e ndermjetesimit ne fushen e ndertimit, marrjen pjese ne konkurse apo tendera te ndryshem, persa i perket furnizimit me materiale te cilat parashikohen ne aktivitetin e shoqerise. Ndertimin, montim dhe rikonstruksionin e objekteve te ndryshme civile, kulturore, shteterore, shendetesore, bujqesore, fabrika, uzina, banesa etj. Instalime te sistemeve elektrike, hidraulike, kondicionim, rrjete elektronike, informatike, dixhitale etj. Ndertim dhe rikonstruksionin e rugeve, kanalizimeve, ujesjellsave, bonifikimeve, impiante, ndricim rrugor, sinjalistik rrugore, punime gjelberimi etj. Projektme konsulencia teknike, instalime, punime restaurimi etj. Veprimtari ne fushen e transportit te mallrave brenda dhe jashte vendit, me mallrat te vete shoqerise dhe te te treteve. Import-eksport ne pergjithesi brenda dhe jashte vendit. Import-eksport mobilje, mobilim sallah konferencash, parket, moket. Ndricim, import-eksport, nderrim tavane. Grumbullim dhe transportim te mbetjeve inerte. Prodhimin dhe tregtimin e materialeve te ndertimit. Tregtimin me shumice dhe pakice, prodhimin, instalimin e materialeve te ndertimit ne pergjithesi, te pllakave te dyshemeve si dhe per veshjet e mureve, te aparaturave e materialeve per impiante higjenike dhe sanitare, te impianteve hidraulike, te impianteve te ngrohjes dhe te kondicionimit, te materialeve qe perdoren per veshjen e banjove, te mbulesave e materialeve qe perdoren per mbulimin e banesave si dhe te paneleve izolues - termike dhe akustike, te rreshires termoplastike e materialeve te perbera, te prodhimeve siderurgjike, te materialeve gjysem te perpunuara qe perdoren ne kete fushe. Blerjen, shitjen, kryerjen e çdo veprimi persa i perket materialeve te permendura ne aktivitetin e shoqerise. Shoqeria mund te kryeje veprime qe lidhen me aktivitetin e saj tregtar, industrial per pasuri te luajtshme apo te paluajtshme qe lidhen me objektin e aktivitetit te saj, te jape garanci dhe per te tretet.

Neni 9

Kapitali i Shoqerise

Kapitali i shoqerise "Elio Construction" shpk do te jete 100.000 lekë , 1 kuote me vlerë nominale 100.000 lekë:

- 100 % të kapitalit aksionar , 1 kuote me vlere prej 100.000 leke.

Neni 10

Transferimi i kapitalit

Pjesë të kapitalit mund të transferohen vetëm me vendim te ortakeve.

Pjesë të kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve të shoqërisë.

Pjesë të kapitalit mund të transferohen tek një palë e tretë, pasi u refuzohet parablerja nga ortaket aktualë.

Pjesë të Kapitalit janë të transferueshme ne rrugë trashëgimie, pas vendimit të ortakeve për transferimin e kapitalit ndaj trashëgimtarëve.

Neni 11

Zvogelimi apo Rritja e kapitalit

Ortakët mund të rrisin ose të zvogelojnë kontributin e tyre në kapitalin themeltar vetëm me vendim të ortakëve të saj, në masën e lejuar nga ligji, përndryshe kompania duhet të ndryshojë formën e vet ligjore.

Neni 12

Organet vendimmarrëse

Asambleja e ortakëve/ortaku i vetëm (ose Asambleja e Përgjithshme) themelues është organi i vetëm vendimmarrës i kompanisë. Janë kompetence vetëm e asamblese së shoqërisë detyrat si vijojnë:

- a . Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë
- b . Ndryshojë nenet e këtij statuti
- c . Emërimi apo shkarkimi i Administratorit
- d . Emërimi apo shkarkimi i auditorëve
- e . Përcaktimi i pages dhe shpërblimeve për personat të përmendur në paragrafin c , d
- f . Ndryshojë seline e shoqërisë
- g . Ndryshimi i emrit të kompanisë
- h . Rritja ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë
- i . Ndarja ose anulimi i kuoatave të kompanisë
- j . Riorganizimi dhe prihja e shoqërisë
- k . Miratimi i rregullores së punës për mbledhjen e asamblese së ortakëve
- l . çështje të tjera që kërkohen me ligj ose statut

Neni 13

Mbledhja e Asamblese së Ortakëve

Ne rast se në shoqëri hyjnë me shume se një ortak, mbledhja e Asamblese së Përgjithshme njoftohet me letër ose me e-mail. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe dërgohet të gjithë ortakëve së paku shtatë ditë para datës së caktuar të takimit.

Kur asambleja e përgjithshme nuk mbledhet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjitha palët bien dakord, edhe pse me parregullsi.

Neni 14

Kuorumi

Vendimet që kërkojnë një shumicë të Asamblesë së Përgjithshme bëhen vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që marrin pjesë në votim, zoterojnë më shumë se 30 % të aksioneve.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për vendime me shumicë të cilësuar, mund të marrë vendime të vlefshme nëse të pranishmit votojnë gjysma e numrit të përgjithshëm të votave, votim me postë ose me ruge elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për mungesë të numrit të sipërpermendur të pjesëmarrjes së detyrueshme për realizimin e kuorumit, do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë nga ajo date e përcaktuar me parë.

Neni 15

Vendimet

Asambleja e përgjithshme në rast të hyrjes së me shume se një ortaku në shoqëri, vendos me tre të katërtat e votave të ortakëve për ndryshimin e statutit , rritjen ose zvogëlimin e kapitalit , shpërndarjen e fitimeve , organizimin dhe shpërbërjen e kompanisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave për çështje të tilla si :

- a . Përcaktimi i politikave të shoqërisë,
- b . Emërimi dhe largimi i drejtorëve ,
- c . Emërimi dhe largimi i auditorit,
- d . Përcaktimi i shpërblimit ose shërbimeve për sa më lart

dh. Përfaqësimi në gjykatë ndaj administratoreve të meparshëm
e . Miratimi i rregullores për realizimin e mbledhjes së asamblese

Çdo modifikim ligjor do të duhet të paraqitet pranë QKB për regjistrim brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 16

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme vendos për :

- a . Vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b . Doreheqjen nga përgjegjësia e tij, që gezon, nga zoterimi i kuotave të shoqërisë
- c . Ngritjen e një padie për përfitime nga ai

Kur ortaku përfaqësohet nga person i autorizuar, që përfaqëson konflikt interesi.

Neni 17

Administrimi

Administrimi i shoqërisë bëhet nga administratori i saj

Administratori drejton punën e përditshme të kompanisë

Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Ekzekutimi i operacioneve të përditshme të kompanisë,
- Përfaqësimi i shoqërisë në lidhje me palët e treta,
- Zhvillimi dhe për të ruajtur buxhetet , auditorët e propozuara , nëse është e nevojshme,
- Përgatitja e dokumenteve në emër të kompanisë,
- Përgatitja e kontratave të punës dhe zgjidhjen e rastit të tyre
- Aktivitete të tjera të çdo natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj .

Kompania drejtohet nga administratori Arjeta Ndoci shtetase Shqiptare e lindur më 14/12/1987 në Krujë, identifikuar me kartë ID nr 037527774 e vlefshme deri me 03/08/2031, madhor e me zotesi të plotë ligjore për të vepruar për jo më shumë se pesë vjet, me të drejtën e rinovimit .

Neni 18

Viti ushtrimor

Viti financiar i kompanisë së fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 . Dhjetor.

Viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë nis nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon në 31 dhjetor.

Neni 19

Bilanci

Bilanci i kompanisë kontrollohet nga organi administrativ, verifikohet nga auditorët, në rast se kërkohet nga ligji dhe paraqitet për miratim të tij nga Asambleja e Përgjithshme brenda 31 Marsit të vitit të ardhshëm.

Llogaritë mbahen në gjuhën dhe monedhën shqiptare . Kompania mund të ketë llogari të ndara në monedhë të huaj.

Shoqëria mund të marrë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë vendit . Për këtë qëllim , kompania mund të jap si kolateral pasuritë e saj, pjesë të pronës, me vendim të Asamblese së përgjithshme.

Neni 20

Të ardhurat , dividendët

Kompania do të krijojë fonde rezervë për realizimin e objektit të shoqërisë,

Fitimi pas fundit të vitit dhe pas pagesës së taksave mund të ndahet nga ortake e shoqerise pasi ehste paguar dividenti.

Neni 21

Shpërbërja dhe Likuidimi

Shpërbërja e kompanisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a . Me përfundimin e kohezgjatjes se saj
- b . Me vendim te ortakeve
- c . Me hapjen e procedurave te falimentimit
- d . Nëse nuk zhvillohet aktivitet për dy vjet të vazhdueshme dhe nuk është njoftuar pezullimi prane QKR.
- e. Me vendim gjykate

Për të realizuar procedurat e likuidimit, ortaket ose assambleja mund te emërojnë një ose disa likuidatorë.

Ne fund të këtij procesi, ortaku do të informohet me bilancin përfundimtar dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë aktivitetit të kompanisë, nëse nuk zgjidhet me pajtim, palët i drejtohen Dhomes Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazhit Tregtar, përveç kur kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në bazë të ligjit është gjykata shqiptare.

Dt 06/10/2021

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

ARJETA NDOCI

Arjeta Ndoci